

NE JEMI TË PËRGJEGJSHËM PËR VEPRIMET TONA




DEMOKRACIA, SISTEM I PAQES DHE VLERAVE

ERSON (10), ANIDA (10), SARA (10), EGZONA (10), ARBEN (10), AGON (10)



Unë jam qytetar i një shteti demokratik, sepse gëzoj shumë liri dhe drejta që i kam të mbrojtura me ligj

Demokracia më ka mundësuar lirinë, barazinë dhe respektin. Ajo më ka bërë që ta kuptoj se çfarë vlere kam unë si qytetar. Demokracia me elementet e saj përbërëse, ka ndikuar që të gjithë të jemi të barabartë me njëri-tjetrin. Ne, nëse nuk do të kishim demokracinë, nuk do të na ofroheshin të gjitha këto të drejta



Votimi e fuqizon demokracinë

dhe liri që i kemi, prandaj jemi shumë mirënjohës për këtë sistem. Kemi shumë raste në klasën tonë kur e shohim vlerën e këtij sistemi. Për shembull, ne me votat tona e zgjedhim kryesinë e klasës, që i bie se zgjedhim lirshëm. Po ashtu, ne shprehemi lirshëm dhe shpeshherë idetë tona vihen në zbatim dhe tregohen shumë efektive për shkollën. Vlen të theksohet se edhe në familjet ku ne jetojmë, ndihemi mirë dhe

të lumtur, sepse prindërit tanë nuk bëjnë dallime. Në rastet kur duhet të merren vendime të ndryshme familjare, prindërit tanë i marrin parasysh edhe kërkesat tona. Këtë ata e bëjnë, sepse janë të vetëdijshëm se në shtetin demokratik idetë e të gjithëve kanë peshë të madhe. Pra, falë demokracisë e cila është shfaqur në vitin 507 p.e.s. në Greqi, jeta e shumë qytetarëve ndryshoi për të mirë. Demokracia, ende nuk e ka arritur zhvillimin e plotë. Për këtë arsye, ne nuk do të ndalemi me kaq. Gjithmonë, do të kontribuojmë me forcat tona për zhvillimin e saj, sepse me të vërtetë e dijmë se çka do të thotë të jetosh në paqe. Ndryshimin nuk mund ta bëj vetëm një person. Atë duhet ta bëjmë të gjithë ne, me punë dhe me përkushtim. Ne jemi në proces të zhvillimit të demokracisë, prandaj japim fjalën se do të vazhdojmë kështu të veprojmë, derisa të arrijmë një nivel të kënaqshëm e ndoshta edhe më shumë. Kërkojmë edhe ndihmën tuaj për këtë aspekt.



Demokratët e rinjë

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË TONA

ERION (10), ERONA (10), LEONARD (10), FESTIM (10), DAUT (10), BEQIR (11), ALTINA (11), HASAN (10), SAMIRE (11), GENTA (10)

Përshëndetje, të dashur. Ne jemi nxënësit të cilët sot u bëmë gazetarë. Vijnë nga shkolla „Mustafë Venhari“ dhe jemi klasa V-2. Sot për juve kemi nder të shkruajmë për të drejtat e fëmijëve

Të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta dhe kanë përgjegjësi, bashkë me ato të drejta. Në disa shtete, fëmijët nuk i kanë këto të drejta. Ne duhet t'u ndihmojmë atyre me mundësitë tona. Në demokraci ne gëzojmë të drejta të shumta. Por, këtu do t'i numërojmë vetëm disa nga to. Ne kemi të drejtë të kemi një familje, një strehë, kemi të drejtë të arsimohemi, të kemi një emër, të kemi një pasaportë, të lëvizim lirshëm, kemi të drejtën e kujdesit shëndetësor, e plot të tjera. Këto të drejta mbrohen nga dy dokumente shumë të rëndësishme, që janë Konventa e të Drejtave të Fëmijëve dhe Kushtetuta e Kosovës. Kurse, dy datat më të rëndësishme për ne fëmijët janë: 1 qershori dhe 20

nëntori, të cilat janë të njohura si Dita Ndërkombëtare dhe Dita Universale e Fëmijëve. Përpos të drejtave, ne kemi dhe përgjegjësi, të cilat janë: të shkojmë në shkollë, të mësojmë, të bëjmë detyra, të pastrojmë, të respektojmë të moshuarit dhe të gjithë personat e tjerë. Tani dëshirojmë të tregojmë një ngjarje shumë interesante. Disa nga shokët tanë ishin në autobus duke shkuar në shtëpi. Brenda në autobus hyri një i moshuar, por ai nuk kishte vend për t'u ulur. Ne si fëmijë të mirë dhe qytetarë të përgjegjshëm ia liruam vendin. Ai na falenderoi shumë dhe na tha: "Sa fëmijë të mirë jeni!., Ne u bëjmë thirrje të gjithë fëmijëve të sillen kështu sikur ne në të gjitha vendet publike.



Të gjithë jemi të barabartë dhe të lumtur



Fëmijët qëndrojnë të bashkuar



Fëmijët gazetarë të këtij artikulli



Kur sëmuremi, ne kemi të drejtë të shërohemi

NE I ZGJEDHIM, ATA NA PËRFAQËSOJNË

SADIK (10), SONER (10), EGZON (11), ARJANITA (10), EDVIN (10), ARMIR (10), GETUAR (10), GENT (10),

ALTINË (10), DIART (10)



Në përditshmërinë tonë, ne bëjmë zgjedhje të ndryshme. Më poshtë do të keni mundësi të lexoni se si ne si grup zgjedhim në shkollën tonë

Unë jam Genti dhe në emër timin dhe të grupit „Bletat Punëtore“, do ta tregoj një ngjarje. Ne, nxënësit e klasës V-2, kemi shumë dëshirë të luajmë futboll. Ne luajmë shumë shpesh, ku zakonisht ndahemi në dy grupe dhe kështu luajmë me shumë dëshirë. Por, ka raste kur ne luajmë me klasë të tjera.

Ne nuk mund të luajmë të gjithë nxënësit e klasës, për shkak se ne je jemi më shumë se sa ç'kërkohej në një lojë futboll. Në këto raste, ne së bashku me kapitenin e klasës për futboll Diartin, i zgjedhim lojtarët më të mirë të klasës sonë dhe kështu e formojmë ekipin e klasës. Për të qenë të drejtë me të gjithë, jo çdo herë i zgjedhim të njëjtit nxënës, sepse të gjithë kemi të drejtë të jemi pjesë e një loje futboll. Ne e duam shumë futbollin dhe ajo që na bënë më së shumti të lumtur është kur ne vetë i zgjedhim lojtarët më të mirë.

Ky është vetëm njëri nga rastet, ku ne kemi bërë zgjedhjen tonë. Ne bëjmë edhe zgjedhje të tjera bashkë me mësuesen tonë. Për shembull, kryetarin e klasës e kemi zgjedhur bashkarisht, aktivitetet e ndryshme të cilat i zhvillojmë në klasë, po ashtu, i zgjedhim bashkë. Përveç zgjedhjeve që i bëjmë në grup, ne mund të bëjmë edhe zgjedhje tona individualisht. Për shembull, ne zgjedhim se si të vishemi, se si t'i mbajmë

flokët, etj.

Kur të arrijmë moshën 18 vjeçare, ne do të marrim pjesë edhe në procesin zgjedhor shtetëror. Dy llojet e zgjedhjeve në Kosovë janë: zgjedhjet lokale, ku qytetarët e një komune votojnë për ta zgjedhur kryetarin e komunës dhe asamblistët, si dhe zgjedhjet qendrore, ku qytetarët e gjithë Kosovës votojnë për zgjedhjen e deputetëve, të cilët edhe janë përfaqësuesit tanë në institucionin e Kuvendit të Kosovës.

Ne jemi shumë të lumtur, sepse edhe brenda grupit tonë, këtu në Punëtorinë për Demokraci „Demos-ti“, kemi pasur mundësinë të zgjedhim vetë se cilën punë ta kryejmë. Kjo dëshmoi se ne vërtet kemi frymë demokratike dhe kështu duhet të veproni edhe ju lexues të dashur. Vetëm duke bashkëpunuar ne mund ta forcojmë demokracinë.



Ne jemi gazetarët e grupit „Bletat Punëtore“

NE AKTIVIZOHEMI PËR KOMUNITETIN TONË

ERMIRA (10), YLLKA (10), ADRIATIK (10), MUHAMED (10), ALBENIT (10), BLERON (10)



Komuniteti ku jetojmë është shumë i rëndësishëm për ne. Prandaj, ne mundohemi që t'i respektojmë rregullat dhe ligjet në mënyrë që ta bëjmë veten dhe t'i bëjmë qytetarët e tjerë të lumtur

Qytetarë janë të gjithë ata, të cilët jetojnë brenda një shteti të caktuar, pa marrë parasysh se a ka ai shtet sistem demokratik, apo ndonjë sistem tjetër. Por, në shtetet me sistem demokratik, liria për të vepruar dhe për t'u aktivizuar në të mirën e komunitetit është më

të. Pa dyshim, kjo vënie nga fakti se ne jemi qenie sociale ku duhet dhe kemi mundësi t'i ndihmojmë të tjerëve. P.sh. ne në shkollë, së bashku me të gjithë nxënësit, kemi marrë një iniciativë dhe i kemi mbledhur mbeturinat dhe kemi pastruar tërë oborrin e shkollës. Këtë e kemi bërë, pasi që e dimë se si ndikon ndotja e ambientit në shëndetin tonë dhe nuk duam që një veprim i papërgjegjshëm i dikujt të ndikojë një shoqëri të tërë. Po ashtu, kemi marrë shumë iniciativa të tjera pozitive, vetëm e vetëm që të kontribuojmë për shtetin. Kjo pra është qytetaria aktive, ku qëllimi parësor i saj është krijimi i një shoqërie të shëndoshë. Prandaj, iu ftojme të gjithëve të aktivizoheni dhe të bëni veprime të duhura. Sepse edhe zgjedhja juaj profesionale ndikon që të jeni aktiv. Nëse dikush bëhet mjek/e në të ardhmen, ai/a jo nuk do të kontribuojë vetëm vetes së tij/saj, por tërë komunitetit. Këtu pra, mund ta shihni se sa i rëndësishëm është kontributi i gjithsecilit.



Këtu mund ta shihni fytyrën e ndritur të një qytetari aktiv

e madhe. Siç edhe e dimë, të gjithë duhet ta ndiejmë përgjegjësi zhvillimin e shtetit tonë. E shteti ynë, mund të zhvillohet vetëm nëse ne jemi qytetarë aktiv. Edhe ne si nxënës të klasës së V-të, jemi munduar çdo herë që me mundësitë që i kemi ti shërbejmë komunitetit tonë. Jemi duke e përdorur fjalën komunitet, për arsye se në secilin vend që ndodhemi, ne veçse bëhemi pjesë e atij vendi dhe duhet të kujdesemi për



Qytetarët aktiv, ngrisin zërin e tyre për komunitetin



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Mustafë Venhari“
Klasa: V-2
Vendi: Vushtrri